

# RELACION

---

Mbi takimin konsultues në kuadër të hartimit të Planit të Veprimit OGP 2026–2030

Kontributi i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)

Në kuadër të procesit të bashkë-krijimit për hartimin e Planit të Veprimit të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP) 2026–2030, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) organizoi një takim konsultues me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile.

Takimi u zhvillua me pjesëmarrjen e rreth 18 organizatave të shoqërisë civile, të cilat kontribuan aktivisht përmes diskutimeve, sugjerimeve dhe ndarjes së përvojave konkrete në lidhje me sfidat dhe prioritetet në fushën e qeverisjes së hapur.

## Qëllimi i takimit

- Të sigurohej përfshirja aktive e shoqërisë civile në procesin e hartimit të Planit të Veprimit OGP;
- Të identifikoheshin problematikat kryesore që hasen në praktikë;
- Të mblidheshin rekomandime konkrete për përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes qytetare.

## Çështjet kryesore të diskutuara

- Nevoja për rritjen e transparencës në proceset e vendimmarrjes publike;
- Përmirësimi i mekanizmave të konsultimit publik dhe përfshirjes së qytetarëve;
- Forcimi i rolit të organizatave të shoqërisë civile në monitorimin e politikave publike;
- Rritja e aksesit në informacion publik dhe përdorimi i të dhënave të hapura;
- Mbështetja financiare dhe teknike për organizatat e shoqërisë civile.

## Kontributi i AMSHC

- Facilitimi i dialogut ndërmjet institucioneve publike dhe shoqërisë civile;
- Nxitja e pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse dhe të barabartë;
- Kanalizimi i rekomandimeve drejt procesit të hartimit të planit të veprimit;

- Ofrimi i ekspertizës në fushën e mbështetjes së organizatave të shoqërisë civile.

### **Konkluzione dhe masa të rekomanduara**

1. Forcimi i mekanizmave të konsultimit publik
2. Rritja e transparencës institucionale
3. Zgjerimi i aksesit në të dhëna të hapura
4. Fuqizimi i rolit të shoqërisë civile
5. Mbështetje financiare dhe kapacitete
6. Përmirësimi i koordinimit ndërinstytucional